

UDHËZIM
Nr. 30, datë 24.8.2015

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 24, DATË 31.7.2015 “PËR
ZHVILLIMIN E KONKURSEVE TË PRANIMIT DHE TARIFËN E
REGJISTRIMIT PËR KONKURRIM NË DISA PROGRAME STUDIMI TË CIKLIT
TË PARË ME KOHË TË PLOTË, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT
TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2015-2016”**

Mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 33 dhe 75 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 638, datë 22.8.2015 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015-2016”, si edhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 78, datë 8.2.2006 “Për krijimin e maturës shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 24, datë 31.7.2015, në fund të pikës 7, shtohet fjalia si më poshtë:
“Për universitetin e Arteve të Tiranës periudha e regjistrimit të jetë deri në orën 12.00 të datës 25 gusht 2015.”.
2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP) dhe Universiteti i Arteve të Tiranës.
Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla